



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 158 Prot.

Tiranë, më datë 28.02.2025

VENDIM

Nr. 142, datë 28.02.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.02.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e projektit *“Rikonstrukcion i shtëpisë së rrënuar 2 katëshe”*, brenda Qendrës Historike dhe zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit, me aplikues Z. Saimir Vukaj dhe zhvillues **Z. Andi Bejleri, me rekomandimin:**
 - Të realizohen nga DSHA sondazhe arkeologjike në pjesën përreth objektit me qëllim investigimin e potencialit arkeologjik të nëntokës;
 2. Shpenzimet për realizimin e sondazheve do të mbulohen nga zhvilluesi sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 143, pika 2;
 3. Rezultati i sondazheve arkeologjike duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
 4. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 72, pika 1 dhe 2;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

